



Pranuar / Dorezuar Pitmi/Prodato Received/Delivery	20.05.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHKENCË	2946/2022		114



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.348/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.348/2022 të datës 08.04.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi kundër organit të punësimit Inspektorati i Arsimit në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 20.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.348/2022 e datës 08.04.2022 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi tani i pensionuar, më datë 08.04.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër përgjigjes me numër reference 10/164 të datës 09.03.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Arsimit në kuadër të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 13.04.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, ndërsa kjo e fundit me datë 26.04.2022 ka përcjell përgjigjen në ankesë me numër protokollit 2411/2022 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 10964/2022 të datës 08.04.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën me numër 127 të datës 24.02.2022;

Përgjigjen në kërkesë të datës 09.03.2022; Vendimin me numër Ref.10 Nr.1130 të datës 31.12.2021; Vendimin për pensionim me numër Ref.10, nr. protokollit.629 të datës 13.07.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 2056/2022 të datës 13.04.2022; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 2411/2022 të datës 24.10.2022; Akt emërimit të datës 24.10.2011; Formularin e datës 10.01.2022; Dëshminë e vitit 2013 lidhur me kompensimin e shtesës lidhur me përvojën e punës në Shërbim Civil; Dëshminë lidhur me kompensimin e pagës përcjellëse me rastin e pensionimit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dërguara nga palët në procedurë, konstatoi së është e pabazuar ankesa e ankuesit **SEPSE:**

Nga administrimi i provat material lidhur me çështjen respektivisht sipas Akt emërimit të datës 24.10.2011 rezulton se ankuesi ka qenë i punësuar në Inspektoratin e Arsimit në pozitën e punës *Inspektor i Arsimit*. Të njëjtit me Vendimin me numër Ref:10 nr.prot.629 të datës 13.07.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Arsimit i është pushuar marrëdhënia e punës me datë 01.01.2022 për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, ndërsa përmes Vendimit ref.Nr.1130 të datës 31.12.2021, Drejtori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Arsimit i ka njohur të drejtën e kompensimit të një pagesë në shumën prej një page mujore të menjëhershme në vlerën e pagesës së fundit për arsye të arritjes së moshës së pensionimit.

Ankuesi me datë 24.02.2022 ka parashtruar kërkesë pranë Inspektoratit të Arsimit, për pagesën e tri pagave përcjellëse, tri pagave jubilarë, pagën e rrezikshmërisë në punë dhe shujtat sipas Kontratës Kolektive me Nr.24 të datës 18.04.2017 e lidhur në mes të MASHT dhe SBASHK-ut dhe pagesa shtesë në bazë të nenit 26 të Ligjit Nr.06 L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës.

Në përgjigje të kërkesës së ankuesit të datës 24.02.2022, Drejtori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Arsimit me shkresën me nëmurr reference 10/164 të datës 03.09.2022, ka njoftuar ankuesin së duke u bazuar në nenin 22 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe nenin 21 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë ankuesit i janë realizuar kompensimi i shpërblimit në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Shërbim Civil pas çdo 10 vjet përvojë punë në shërbim civil si dhe një pagesë mujore e menjëhershme në vlerën e pagës së fundit me rastin e pensionimit.

Ankuesi i pa kënaqur me përgjigjen me numër reference 10/164 të datës 03.09.2022 ka parashtruar ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me pretendimin ankimorë se organi i punësimit me rastin e pensionimit të ankuesit është dashur që ti kompensoj katër paga jubilarë, tri pagave përcjellëse, shpenzimet e udhëtimit, kompensimin për ushqim gjatë punës sipas Kontratës Kolektive me Nr.24 të datës 18.04.2017 e lidhur në mes të MASHT dhe SBASHK-ut dhe pagesa shtesë në bazë të nenit 26 të Ligjit Nr.06 L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka shqyrtuar bazën ligjore mbi të cilën janë ngritur pretendimet ankimore të ankuesit dhe si rrjedhojë ka konstatuar së Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje Këshilli) ka juridiksionin që të siguroj respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, përmes ushtrimit funksioneve të përcaktuar me nenin 6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës



për Shërbimin Civil të Kosovës ku theksohet se : *Për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, Këshilli ka këto funksione themelore: 1.1. shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil;... 1.3 monitoron institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, Andaj në vështrim të këtyre dispozitave ligjore rrjedhë së Këshilli nuk ka juridiksion që të shqyrtoj rregullat dhe parimet jashtë shërbimit civil respektivisht Kolegji vlerëson së aktet juridike mbi të cilat ankuesi ka bazuar pretendimet ankimore nuk kanë të bëjnë me fushëveprimin e legjislacionit të shërbimit civil, kështu që trajtimi i çështjes ankimore bazohet vetëm në kuptim të legjislacionit të shërbimit civil.*

Kolegji nga shqyrtimi i shkresave të lëndës ka gjetur se organi i punësimit ka bërë kompensimin e një page mujore të njëhershme (pagës përcjellëse) me rastin e pensionimit të ankuesit në vlerën e pagesë së fundit, gjegjësisht 606.37 euro, rrjedhimisht bazuar në këtë konstatim rezulton se Inspektorati i Arsimit ka vepruar në pajtim me nenin 22 paragrafit 2 nën paragrafit 2.2 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe dispozitat e nenit 19 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë i cili përcakton që: *1. Sipas nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit në Shërbimin Civil, gëzon të drejtën e kompensimit". 2. Nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e marrjes së një pagese në shumën e një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagesë së fundit", kështu që pretendimi ankimor i ankuesit për kompensimin e tri pagave bazë përcjellës me rastin e pensionimit është i pa bazuar.*

Përkitazi me pretendimin e ankuesit për kompensimin e katër pagave jubilarë, Kolegji në bazë të dëshmive të lëndës, ka konstatuar se ankuesit në vitin 2013 i është bërë kompensimi i një page jubilarë për dhjetë vjet përvojë punë në vlerën e 25 % të pagës mesatare në shërbimin civil respektivisht në vlerën 82.50 Euro, kështu që nisur nga ky konstatim rrjedhë së organi i punësimit ka vepruar në pajtim me nenin 22 paragrafi 2 nën paragrafi 2.3 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe nenin 21 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë ku përcaktohet se : *"Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësve civilë, të cilët janë në marrëdhënie të vazhdueshme pune në Shërbimin Civil iu takon një shpërblim në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Shërbimin Civil pas çdo dhjetë (10) vjetësh pune".* Andaj nisur nga konstatimi se ankuesit i është bërë kompensimi i shpërblimit jubilar në vitin 2013, Kolegji vlerëson së në kohën e pensionimit të të njëjtit nuk janë plotësuar gjithsej 10 vite tjera të përvojës së punës në shërbim civil, kështu që pretendimi i ankuesit në këtë kuptim është i pabazuar.

Siç u tha me sipër, Kolegji duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.348/2022

Ilire Mehmeti Shaqiri


Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Arsimit;
- Menaxherit të Personelit në MASHTI dhe
- Arkivit të KPMShCK-së.